



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
 Komisioni për Buxhet dhe Financa
 Mbledhja nr. 99/13
 Prishtinë, më 20.03.2013, ora 12:00
 Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Sevdije Lama, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Naser Osmani.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Safet Hoxha Kryetar i KRPP-së, Hysni Hoxha Kryetar i OSHP-së dhe Agim Sheqiri nga OSHP, Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga Zyra e Presidentes.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj- kryetare e Komisionit

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit dt. 13.03.2013;**
3. **Shqyrtimi i Vendimit të Presidentes për kthimin e Ligjit për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor;**
4. **Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për tarifën e veçanta të akcizës për prodhimin fillestar dhe prodhimin e vogël të produkteve alkoolike të prodhuara në Kosovë;**
5. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012;**
6. **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012;**
7. **Shqyrtim i Raportit me rekomandime të grupit punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Projektligjin Nr. 04/L-150 për odat e profesionistëve shëndetësor dhe amendamenteve të Komisionit funksional;**
8. **Shqyrtimi i Projektligjit për provimin e jurisprudencës me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion;**
9. **Shqyrtimi i projektligjit Nr. 04/L-184 për administrimin e punës në zyrë;**

10. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.04/L-161 për sigurinë dhe shëndetin në punë me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale;
11. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-176 për turizmin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
12. Miratimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimi të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221 dhe Ligjin Nr. 04/L-116;
13. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për Sistemin e Pagesave;
14. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoj që pika 3, 4, 7, e rendit të ditës të shtyhen në mbledhjen e radhës

Rendi ditës u miratua me ndryshime. Pika 3, 4 dhe 7 shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 13.03.2013

Kryetarja theksoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012

Kryetarja konstatoi se Raporti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ka ardhur me kohë në Kuvend. Në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik raporti i KRPP-së përfshin të gjitha aktivitetet për vitin 2012, përkatësisht përfshihet numri i kontratave të nënshkruara që është 12045 (nga të cilat 9112 janë në nivel Qeveritar, 2910 Kompani Publike ndërsa 23 të tjera). Kontrata Kornizë, në vitin 2012 janë përdorur pothuajse nga të gjitha autoritetet kontraktuese. Poashtu në raport janë të përfshira vlera e kontratave sipas operatorëve ekonomik, sipas afatit kohorë për publikim dhe sipas kriterëve për dhënie kontratës. Ky numër i kontratave përfshinë 10.40 % e BPV. KRPP-ja ka dorëzuar raportin shtesë financiar të plotësuar sipas formularëve të miratuar nga komisioni.

Safet Hoxha theksoi se Raporti i KRPP-së përfshin të gjitha aktivitetet e Prokurimit Publik, dhe përmes këtij raporti ka arritur të pasqyroj ecurinë e gjithëmbarshme të Prokurimit Publik në Kosovë. Të dhënat që kemi nga autoritetet kontraktuese tregojnë se këtë vit janë realizuar 12045 aktivitete që në shumën totale të mjeteve bëjnë 507,863,303.89 € pa përfshirë vlerën e pagesës së Autostradës Morinë- Merdarë. Vlen të theksohen se aktivitetet e Prokurimit të financuara nga buxheti i Kosovës përfshin 318,593,149.00 €. Pjesa tjetër ka qenë prej të ardhurave vetanake, ku kemi një rënje të investimeve në kompani publike që janë bërë për shkak të privatizimit si dhe kërkesës së Qeverisë për ti reduktuar këto investime. Sqaroj vlerën e të dhënave dhe rritjen e kontratave për punë, autoritetet kontraktuese i kanë ikur shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve. Nga analiza që është bërë në nivel qeveritar kemi një ulje të procedurës së negociuar. Indikator i këtij viti është rritja e numrit të ofertuesve në aktivitet të prokurimit publik. Për progresin në fushën e prokurimit publik, ekziston edhe mendimi i Komisionit Evropian sipas të cilit amendamenti ka arritur të përfshijë direktivat kryesore të BE-së. Sa i përket monitorimeve janë realizuar 24 monitorime të rregullta dhe 11 monitorime sipas rastit, 3 monitorime të implementimit të kontratës, 2 hapje të aktivitetit të prokurimit publik dhe 1 hetim sipas kërkesës tonë. Konstatoi se gjendja e prokurimit publik është e kënaqshme por e kemi një problem se njerëzit vijnë,

aftësohen dhe ikin në vende ku paga është më e mirë. Buxheti i realizuar është 99,47% dhe një realizimi i mirë është në të gjitha kategoritë ekonomike.

Kryetarja konstatoi se meqenë se në raportin e progresit është cekur se garantohet qasja e barabartë e kompanive vendore dhe të BE-së, ndërkaq ne kemi miratuar ligjin që është në harmoni me direktivat e BE-së. Në strategjinë legjislative e kemi plotësuar ndryshimin e ligjit për Prokurim Publik Komisioni për Buxhet dhe Financa ka formuar një grup punues që do të bëjë monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit si Komision Rregullativ a jeni në dijeni se çka po ndryshohet në ligj dhe a keni informata pse është përfshirë në strategjinë legjislative.

Safet Hoxha sqaroi se plotësuar ndryshimi i ligjit të prokurimit publik ka rrjedh si iniciative e Komisionit për Zhvillim Ekonomik. Me kërkesën e zj.Kusari është dhënë një ide që të ndërtohen preferenca në kuadër të ligjit për kompanitë vendore dhe produktet. Mendoj që secili prej nesh solidarizohemi me këtë ide por do të jetë problem harmonizimi me direktivat e BE-së për prokurimin publik. Ku në nivel vendi kemi 17,77 % të prokurimit publik të fituara nga kompanitë e huaja ndërsa Komisioni Evropian kërkon të krijohet qasje më e mirë e biznesit të huaj në Kosovë. Sado që të jetë ide e mirë Qeveria dhe legjislativi duhet të gjejnë alternativa tjera për stimulim të biznesit vendor.

Kryetarja theksoi se është edhe një problem tek aneksi i shpenzimeve buxhetore, në tabelën e përgjithshme janë të shënuara investimet kapitale, të cilat nuk janë të parapara me ligjin për buxhet as me materialin të cilin e keni sjell.

Safet Hoxha sqaroi se është përmirësuar në raportin analitik sepse në përshkrimin teknik është bërë një zhvendosje e pozicionit të pagave të punëtorëve e cila është përsëritur.

Hykmete Bajrami duke u nis nga fakti se e kemi në strategjinë legjislative ligjin për Prokurim Publik do të doja të dija se cilat janë sfidat në Prokurimin Publik pasi që e dijmë se nga aty na vie niveli i lartë i korrupsionit prej nga edhe akuzohemi nga Bashkësia Evropiane se kemi një ligj të keq dhe i cili nuk po arrin zbatim në praktikë. Sa i përket monitorimeve, nëse ne bisedojmë me operatorët ekonomikë ata na tregojnë se me specifikimin e kriterëve për kontrata të ndryshme të furnizimit vihen kriterë të cilat i plotësojnë vetëm kompanitë e caktuara. Pra, bëhet përgatitja e terrenit që kompania e caktuar ta fitoj tenderin. A do të duhej të kemi një ligj i cili në përgjithësi do të ketë kriter çmimin më të ulët? Sa i përket iniciativës për favorizim të kompanive vendore mendoj se është iniciativë e mirë, por vërehen pengesat në harmonizim me direktivat e BE-së, ndoshta do të duhej që Qeveria të bëjë favorizimin e kompanive vendor më ndrysh dhe kjo nuk ka nevojë të jetë rregull i shkruar por ka forma të shumta me të cilat mund të bëhet favorizimi i produkteve vendore. Ndërsa sa i përket indikatorit 17.77% ku Komisioni Evropian ka ankesa për pjesëmarrje të vogël dhe kërkon hapje të tregut për operatorët e jashtëm duhet ti shtohen statistikat e tjera se kemi deficit tregtar prej 2.2 milion €.

Safet Hoxha sqaroi se duke qenë treg i vogël shpesh nuk është i interesuar për kompani të mëdha është më tepër treg konsumues ku prodhohet më pak. Sa i përket monitorimeve dhe sfidave që i shohim kemi bërë 24 monitorime, shumica e gabimeve janë të natyrës administrative. Sfidë e prokurimit mbetet ndërtimi i një zingjiri të qëndrueshëm mes njësisë së kërkesës zyrës së prokurimit dhe njësisë implementuese. Zyrtarët që merren me prokurim publik paguajnë faturat e njësisë së kërkesës dhe njësisë implementuese. Pjesa e dytë e problemit që krijohet në prokurim publik është implementimi i kontratave. Ligji ka përcaktuar masa ndaj asaj që kompanitë publike apo private kanë të drejtë

parashtrimin të ankesave të specifikuara. Ajo e cila vazhdon të diskutohet është çmimi më i lirë dhe më i favorshëm ekonomikisht, praktika në nivel të BE-së është duke lëviz nga çmimi më i favorshëm. Duhet bërë përpjekje për të futur çmimin më të lirë në punë në mënyrë që edhe operatorët të jenë më të dinjitetshëm në treg. E metë e këtij ligji është shikimi vetëm i interesit të shtetit dhe jo të operatorit ekonomik, si rezultat i kësaj gjendja e operatorëve është e rëndë.

Sali Asllanaj pyet se projekti i autostradës a hyn në 17.7 % sepse vërejmë se mbi 50 % janë kontraktues real nga jashtë? A keni vërejt ndryshimet të cilat janë bërë në ligj a kanë dhënë efekte pozitive dhe me çka janë të lidhura? Pasi që ka pasur disa avancime në procedura a është efekt i këtyre përgjegjësi që kanë marrë autoritetet politike.

Latif Gashi kërkon të dijë se cili është roli i institucionit tuaj prej momentit që një operator e merr një projekt kapital nëse respektohet çmimi më i lirë? A keni ndonjë rol në këtë çështje apo kalon në kompetenca të ndonjë Ministrie?

Safet Hoxha sqaroi se autostrada nuk është aktivitet i vitit 2012 dhe si e tillë nuk hyn. Sa i përket nënshkrimit të kontratave nga stafi politik mendoj se ka rezultuar në ngritje të disiplinës në procesin e prokurimit, ka ndikuar në rritjen e aktiviteteve kontraktuese. Roli i KRPP-së në monitorimin e kontratave është një departament i cili bën monitorimin e kontratave, dallimi i këtij ligji me ligjet tjera është decentralizimi me fushën e prokurimit. Nuk kemi kapacitete për të ushtruar një monitorim përmbajtësor do të thotë nuk kemi eksperte të ndërtimtarisë, farmacis dhe nuk kemi të drejt dhe fonde për të investuar në ekspert të jashtëm në këtë fushë. Roli ynë është më shumë në matjen e performancës të kësaj pune se sa për monitorim përmbajtësor të kësaj fushe.

Kryetarja të gjithë anëtarët e komisionit janë të mendimit që raportit i përfshin të gjitha çështjet që janë të parapara me ligj që të prezantohen. Rekomandoi që të miratohet raporti nga ana e komisionit dhe të rekomandojmë në seancën plenare për miratim.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj raportin vjetor të KRPP-së për vitin 2012.

Kryetarja konstatoi se Raporti vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit ka ardhur me kohë në Kuvend. Raporti i OSHP-së përfshin të gjitha aktivitetet për vitin 2012 përkatësisht numri i ankesave të refuzuara për shkak të mungesës së afateve kohore, numri i ankesave që janë konstatuar se nuk përmbajnë pretendime të vlefshme, numrin e ankesave që janë anuluar si rezultat i një ankese. Informatat e detajuara mbi një ngjarje ku autoriteti kontraktues ka dështuar në respektimin e një urdhërese të OSHP-së dhe numrin e procedurave të shqyrtimit që kanë rezultuar në konstatim se aktiviteti përkatës i prokurimit dhe dhënia ose vendimi janë bërë në mënyrë të vlefshme. Në raportin vjetorë është bashkangjitur sipas ligjit edhe raporti financiar, në të janë të përfshira edhe të dhënat në mënyrë të detalizuar.

Hysni Hoxha theksoi se buxheti i OSHP-së për vitin 2012 ka qenë 288.508.00 dhe krahasuar me vitin e kaluar ka pasur një rritje prej 5.6% në kategorinë paga dhe mëditje . Buxheti vjetor i shpenzuar është në masën 89.78% dhe pjesa më e madhe e buxhetit të OSHP-së është shpenzuar për paga 47% , mallra

dhe shërbime 40%,shërbime komunale 1.5% si dhe të pa shpenzuara 11.5%. Trajnimet i është kushtuar kujdes i veçantë me theks që lidhen me problematikat të veçanta të prokurimeve dhe partneritetit publiko-privatë. Një nga prioritetet e veprimtarisë së OSHP-së, ka qenë promovimi i aktivitetit të këtij institucioni , i procedurave të shqyrtimit të ankesave dhe rezultateve të arritura në përmbushjen e detyrimeve ligjore.Po ashtu është bërë edhe ridizajnimi i Web faqes zyrtare. OSHP-ja gjatë kësaj periudhe njëvjeçare ka pranuar gjithsejtë 379 ankesa nga operatorët ekonomik. Autoritetet Kontraktuese që kanë më së shumti ankesa të pranuar janë Ministria e Infrastrukturës 40, Korporata Energjetike 34 dhe Policia e Kosovës 16. Urdhëresat e shqiptuara për mos respektim të vendimit të OSHP-së janë gjithsej 8. Gjithashtu OSHP-ja realizon të hyra nga gjobat e shqiptuara dhe depozitat e ankesave.Të hyrat nga gjobat janë gjithsej 40,000 ndërsa të hyrat nga depozitat 92,638.

Hykmete Bajrami arsyet se pse njëzetepesë operatorët ekonomik i kanë tërhequr ankesat e tyre ku dihet se për të shtruar një ankesë duhet të paguhet. Ndërsa çështja tjetër ka të bëjë me rivlerësimin 102 ankesat të cilat OSHP-ja i ka pranuar , ju i keni kthyer në rivlerësim atëherë qfarë ndodhë pas rivlerësimit ngase është pse kthehen në rivlerësim tenderët prapë i'u jepen të njëjtëve operatorë ekonomik që ju kanë dhënë më herët autoritetet kontraktuese ?.Po ashtu operatorët ekonomik që janë futur në listën e zezë duhet të dihen , dhe të ketë masa ndëshkuese për autoritetet kontraktuese që nuk e përfillin dhe e shkelin me plot vetëdije ligjin e prokurimit .

Hysni Hoxha lidhur me atë se pse njëzetepesë operatorët ekonomik i kanë tërhequr ankesat e tyre në dispozitat e ligjit të prokurimit publik ,shkruan se operatorët ekonomik kanë të drejt t'i tërheqin ankesat e tyre. Ndërsa në rregulloren tonë që kemi aprovuar në vitin e kaluar operatorët kanë të drejtë t'i tërheqin ankesat e tyre deri në fazën kur lënda nuk hynë në panel shqyrtues. Lidhur me rivlerësimin OSHP-ja ka lëshuar tetë urdhëresa me arsye që autoritetet kontraktuese kanë dashtë që mos ta zbatojnë deri në fund vendimin e OSHP-së duke anuluar pastaj ato aktivitete të prokurimit, dhe duke mos e kthyer lëndën ne rivlerësim me arsye se ne kemi vlerësua po tani po e anulojmë sepse nuk kemi interes. Për këtë arsye OSHP-ja ka lëshuar urdhëresa dhe ato më pastaj kanë zbatuar urdhëresat me përjashtim të Universitetit të Prishtinës. Masat ndëshkuese për autoritetet kontraktuese që nuk e kanë përfill dispozitat e ligjit të prokurimit, OSHP-ja ka të drejtë të marrë licencën dhe të dënojë me gjobë minim prej 5000€ ndërsa maksimumi nuk ka limit.

Pas diskutimeve, Komisioni me një votë Kundër (Hykmete Bajrami), asnjë Abstenim dhe të gjithë anëtarët të tjerët të pranishëm Për, nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj raporti vjetor i OSHP-së për vitin 2012.

15. Shqyrtimi i Projektligjit për provimin e jurisprudencës me amendamentet e Komisionit funksional për Legjislacion

Kryetarja theksoi se nga analiza që i janë bërë projektligjit dhe amendamenteve të komisioni funksional nuk kemi vërejtur që përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

Projektligji për provimin e jurisprudencës dhe amendamentet e Komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

16. Shqyrtimi i projektligjit Nr. 04/L- 184 për administrimin e punës në zyrë

Kryetarja theksoi se nga analiza që i janë bërë projektligjit dhe amendamenteve të komisioni funksional nuk kemi vërejtur që përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

Projektligji për administrimin e punës në zyrë nuk përmban implikime buxhetore shtesë

17. Shqyrtimi i Projektligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë me amendamente të Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Kryetarja theksoi se nga analiza që i janë bërë projektligjit dhe amendamenteve të komisioni funksional nuk kemi vërejtur që përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

Projektligji për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe amendamente e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

18. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-176 për turizmin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja theksoi se nga analiza që i janë bërë projektligjit dhe amendamenteve të komisioni funksional nuk kemi vërejtur që përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni , njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

Projektligji për turizëm dhe amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

19. Miratimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimi të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221 dhe Ligjin Nr. 04/L-116

Kryetarja theksoi se nga analiza që i janë bërë projektligjit dhe amendamenteve të komisioni funksional nuk kemi vërejtur që përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

Miratohet Raporti për mbikëqyrjen e zbatimi për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe i njëjti procedohet për miratim në seancë plenare.

20. Miratimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin për Sistemin e Pagesave

Kryetarja njoftoi se komisionet tjera të përhershme e kanë shqyrtuar projektligjin dhe amendamentet e propozuara dhe nuk kanë bërë vërejtje dhe raporti final është i gatshëm procedim në seancë plenare. Kërkohet nga komisioni një votim formal.

Komisioni, njëzëri nxorri këtë:

Rekomandim

Miratohet raporti me rekomandime për Projektligjin për Sistemin e Pagesave dhe i njëjti procedohet për miratim në seancë plenare.

Mbledhja përfundoi: 13:40.

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj